

Ndalimi i ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve

Përgjigje në pyetjet që shtrohen më së shpeshti



Në këtë seri përfshihet edhe:

Ndalimi i ndëshkimit trupor të fëmijëve:

Pyetje dhe përgjigje për fëmijë dhe të rinjë

Ndalimi i ndëshkimit trupor në shkolla:

Përgjigje në pyetjet më të shpeshta

PUBLIKUAR MË 2009 NGA:

Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve

VERSIONI I RISHIKUAR I BOTUAR NË VITIN 2017 NGA:

Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve

www.endcorporalpunishment.org

Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve administrohet nga shoqata për Mbrojtjen e të gjithë Fëmijëve, APPROACH Ltd, një shoqatë bamirëse e regjistruar me nr. 328132.

Zyra e regjistrimit: Foundry, 17 Oval Way, Londër SE11 5RR, MB.

Save the Children Suedi

www.raddabarnen.se; resourcecentre.savethechildren.net

Save the Children Suedi është pjesë e Save the Children Association (Shoqata Save the Children, një fondacion ky që përbëhet prej 29 organizatave të ndryshme të Save the Children, të regjistruara në Zvicër dhe një prej organizatave më të mëdha për të drejtat e fëmijëve në botë. Save the Children Association është edhe pronar i Save the Children International (SCI), që është organizatë ndërkombëtare për implementimin e programit.

Zyra kryesore e Save the Children Suedi: Rädda Barnen, SE-107 88 Stokholm, Landsvägen 39, Sundbyberg, Suedi.

Ky material/botim është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materiali e mban plotësisht hartuesi. Qeveria e Suedisë nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim.

Kur mendojmë për ndalimin e ndëshkimit trupor të fëmijëve, ngriten shumë pyetje, veçanërisht në lidhje me atë se çfarë nënkupton ndalimi për prindërit dhe jetën familjare. Ky doracak ofron përgjigje në shumicën e pyetjeve të shtruara më së shpeshti dhe heq keq-perceptimet për arsyet për ndalimin dhe ndikimin e tij në familje.



Pyetjet

Pjesa 1: Pyetjet për arsyet e ndalimit të të gjitha formave të ndëshkimit trupor

- 8** A dhemb ndëshkimi trupor?
- 10** Ç'është Konventa e OKB-ve për të drejtat e fëmijës dhe çfarë thotë ajo për ndëshkimin trupor të fëmijëve?
- 12** Sondazhet thonë që shumica e njerëzve janë kundër ndalimit zyrtar të ndëshkimit trupor. A duhet t'i dëgjojmë njerëzit?
- 13** Kam dëgjuar shpesh të rinjtë që avokojnë për ndëshkimin trupor - natyrisht që duhet t'i dëgjojmë ata, apo jo?
- 14** Të qenurit i goditur si fëmijë nuk më ka shkaktuar ndonjë lëndim. A do të isha këtu ku jam sot nëse prindërit e mi nuk do të më kishin disiplinuar fizikisht?
- 17** Ka shumë shkelje më të këqija të të drejtave të fëmijëve – pse të fokusohemi në këtë shkelje të vogël?
- 18** Prindërit kanë të drejtë të edukojnë fëmijët e tyre ashtu siç u duket më së miri. A nuk duhet të sfidohen ata vetëm në raste ekstreme të abuzimit të fëmijës?
- 20** Ekziston një dallim i madh në mes të rrahjes së një fëmije dhe një goditjeje të lehtë dashamirëse. A nuk është ndalimi i ndëshkimit trupor i tepërt?
- 23** Pse të mos definohet goditja e lehtë në vend se të ndalohej plotësisht ajo?
- 24** Feja ime kërkon që të përdor ndëshkimin trupor. A nuk do t'ishite diskriminim të më ndalohej përdorimi i saj?
- 26** Pse ta përdorim ligjin lidhur me këtë? Pse nuk i edukojmë prindërit që të mos përdorin ndëshkimin trupor?

- 27** Pjesa më e madhe e ndëshkimit trupor ndodh në familje mbrapa dyerve të mbyllura; do të jetë e pamundur të zbatohet një ndalim, prandaj ç'është ideja e ndalimit?
- 28** Shumë prindër i edukojnë/rrisin fëmijët e tyre në kushte të vështira, dhe mësimdhënësit dhe të tjerët janë në stres për shkak të mbingarkesës dhe mungesës së burimeve. A nuk duhet të presim derisa të përmirësohen kushtet para se të ndalojmë ndëshkimin trupor, në mënyrë që të mos jetë vetëm një stres i shtuar?
- 31** A është kjo një çështje që ka të bëjë me Evropën dhe të bardhët? Ndëshkimi trupor është pjesë e kulturës sime dhe traditës së rritjes së fëmijës. A nuk është diskriminuese ndalimi i saj me ligj?
- 32** Pse është aq e vështirë që të hiqet dorë nga goditja e fëmijëve?

Pjesa 2: Pyetjet për ndikimin e ndalimit të ndëshkimit trupor

- 36** Nëse prindërit detyrohen të heqin dorë nga ndëshkimi trupor, a do të përfundojnë fëmijët të lazdruar, duke mos respektuar askënd dhe asgjë?
- 39** Nëse ndëshkimi trupor ndalohet, a nuk do të shpie kjo në trajtim më të tmerrshëm të fëmijëve - abuzim emocional, poshtërim ose mbyllje brenda?
- 40** A nuk nënkupton kriminalizimi i ndëshkimit trupor që mijëra prindër do të përndiqen dhe që më shumë fëmijë të dërgohen në përkujdesje?
- 42** A nuk është në rregull që prindërit t'i qëllojnë lehtë fëmijët e tyre për t'i ndaluar që të vet-lëndohen?

**Pjesa 1:
Pyetjet për
arsyet e ndalimit
të të gjitha
formave të
ndëshkimit
trupor**



A dhemb ndëshkimi trupor?

Po, sigurisht që dhemb! Ai lëndon fizikisht dhe emocionalisht. Nëpërmjet hulumtimeve që po bëhen në të gjithë botën, fëmijët po fillojnë të na tregojnë se sa ju dhemb ndëshkimi trupor. Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunën ndaj fëmijëve, i përfunduar në vitin 2006, ishte studimi i parë gjithëpërfshirës global mbi natyrën dhe shtrirjen e këtij problemi. "Independent Expert" që drejtoi këtë studim, profesor Paulo Sérgio Pinheiro, shkroi në raport:¹

"Gjatë gjithë procesit të studimit, fëmijët vazhdimisht kanë shprehur nevojën urgjente për të ndaluar gjithë këtë dhunë. Fëmijët dëshmojnë për lëndimin - jo vetëm trupor, por edhe "lëndimin nga brenda" - të cilin ua shkakton kjo dhunë, kombinuar me pranimin e të rriturve, madje edhe me miratimin e saj.

Qeveritë duhet të pranojnë se kjo është me të vërtetë një urgjencë, megjithëse nuk është një urgjencë e re. Për shekuj me radhë fëmijët kanë përjetuar dhunë në duart e të rriturve, të padukshëm dhe të padëgjuar. Por tani që shkalla dhe ndikimi i dhunës ndaj fëmijëve po bëhen të dukshme, ata nuk mund të mbahen më në pritje për mbrojtjen efektive për të cilën ata kanë një të drejtë të pakufizuar."

1. Pinheiro, P. S. (2006), "World Report on Violence Against Children", Gjenevë: Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunën ndaj fëmijëve. Për më shumë informata për këtë studim shkarkoni ne: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Study/Pages/StudyViolenceChildren.aspx>

Shkaktimi i dhimbjes trupore ndaj një fëmije është në vetvete një shkelje e së drejtës së fëmijëve për mbrojtje nga sulmi - dhe të rriturit shpesh nuk e kuptojnë ndryshimin në madhësi dhe forcë midis tyre dhe një fëmije. Ata shpesh nuk e kuptojnë ndikimin që ky ndryshim mund ta ketë në dhimbjen trupore të synuar, dhe atë të ndjerë nga fëmija. Hulumtimet në shkallë të gjerë në të cilat prindërit janë pyetur për forcën e përdorur gjatë "goditjes së lehtë" të fëmijës e tyre kanë treguar se dy nga pesë prej tyre kishin përdorur një shkallë të ndryshme të forcës se sa që kishin menduar.² Edhe hulumtimet nga Instituti i Psikiatrisë dhe Kolegjit Universitar në Londër kanë dëshmuar se ndryshimet në aktivitetin e trurit kur përdoret forca në situata të "shpagimit" natyrisht çon në përshkallëzim të shkallës së forcës së përdorur dhe në pasaktësi në gjykimin se sa forcë po përdoret.³

Përveç kësaj, të rriturit shpesh nuk e vlerësojnë lëndimin emocional të shkaktuar nga ndëshkimi trupor, ndikimin e tij në dinjitetin e fëmijës dhe dëmin e mundshëm afatshkurtër dhe afatgjatë që mund të ketë tek individët dhe shoqëria. Nisma Globale është në dijeni për mbi 250 studime mbi efektet e ndëshkimit trupor që e shoqërojnë atë me një numër të madh rezultatesh negative në shëndet, zhvillim dhe sjellje të fëmijëve, që mund t'i ndjekë ata deri në moshë madhore - kjo përfshinë shëndetin e dobët mendor, zhvillimin e dobët kognitiv, nota më të ulëta në shkollë, rritje të agresivitetit, rregullim të dobët moral dhe rritje të sjelljes anti-sociale.⁴

2. Kirëaun, S. & Bassett, C. (2008), "Presentation to NSPCC: Physical punishment", Byroja britaneze për hulumtim të tregut/Shoqëria kombëtare për parandalimin e mizorisë te fëmijët

3. Shergill, S. S. et al (2003), "Two eyes for an eye: The neuroscience of force escalation", Science, vëllimi 301, 11 korrik 2003, p. 187


4. Për më shumë informata, shihni "Corporal punishment of children: summary of research on its impact and associations", në dispozicion në www.endcorporalpunishment.org

Ç'është Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe çfarë thotë ajo për ndëshkimin trupor të fëmijëve?

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, ose KDF, paraqet listën më të plotë të të drejtave të fëmijëve që janë krijuar ndonjëherë, dhe paraqet traktatin më të ratifikuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut në histori. Konventa ka 54 nene që mbulojnë të gjitha aspektet e jetës së fëmijëve dhe e cila përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore që i kanë të gjithë fëmijët kudo.

Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve ka për detyrë të sigurojë që Konventa respektohet siç duhet nga vendet që e kanë nënshkruar dhe ratifikuar atë. Ky komision e ka bërë të qartë që KDF-ja kërkon ndalimin me ligj, dhe eliminimin në praktikë, të ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset - në shtëpi, ambiente të kujdesit alternativ, kujdes ditor, shkolla dhe sisteme penale. Komenti i Përgjithshëm i Komisionit nr. 8 (2006) për "E drejta e fëmijës për mbrojtje nga ndëshkimi trupor dhe format e tjera mizore ose degraduese të dënimit (nenet 19, 28, paragrafi 2 dhe 37, ndër të tjera)" kanë konsoliduar dhe konfirmuar këto obligime, të cilat përsëriten në Komentin e Përgjithshëm Nr. 13 (2011) për "të drejtën e fëmijës për të qenë i lirë nga të gjitha format e dhunës".

Komisioni e vlerëson në vazhdimësi zbatimin e KDF-së nëpër ato vende, dhe sistematikisht rekomandon ndalimin e ndëshkimit trupor në vëzhgimet e tij përfundimtare. Organet e tjera për monitorimin e traktateve gjithashtu rekomandojnë gjithnjë e më shumë ndalimin, dhe kjo çështje ngritet rregullisht në Shqyrtimin Periodik Universal të të dhënave të përgjithshme të shteteve për të drejtat e njeriut.



Sondazhet thonë që shumica e njerëzve janë kundër ndalimit zyrtar të ndëshkimit trupor. A duhet t'i dëgjojmë njerëzit?

Për këtë çështje - si të tjerat, përfshirë këtu dhunën kundër grave, dhe diskriminimin racor - politikanët duhet të udhëheqin, e jo të ndjekin opinionin publik. Theksi duhet të jetë në obligimin e qeverisë për të siguruar që ligji t'u garantojë fëmijëve, ashtu sikurse të rriturve, mbrojtje të plotë të dinjitetit të tyre njerëzor.

Pothuajse të gjitha vendet që e kanë ndaluar ndëshkimin trupor e kanë bërë këtë përpara opinionit publik dhe pastaj opinionin publik ka ardhur shpejtë në mbështetje të ndryshimit. Pas pak vitesh, të rriturit do të rishikojnë të kaluarën e tyre dhe do të habiten - dhe turpërohen - për kohën kur goditja e fëmijëve konsiderohej e ligjshme dhe e pranueshme.

Rezultatet e sondazheve në përgjithësi varen nga mënyra se si formulohen pyetjet dhe se sa informata kanë të anketuarit. Nëse njerëzit janë plotësisht të informuar për këtë çështje, për pabarazinë ekzistuese në mbrojtjen e fëmijëve dhe qëllimin e ndalimit, ata mund të mbështesin mirë ndalimin - dhe sondazhet e përsëritura kanë treguar rezultate shumë të ndryshme kur pyetja është shtruar në mënyra të ndryshme.

Kam dëgjuar shpesh se të rinjtë flasin në mbështetje në ndëshkimit trupor - a duhet t'i dëgjojmë ata?

Është e vërtetë që fëmijët ndonjëherë thonë se ndëshkimi trupor është i mirë për ta, se u mëson atyre se si të sillen, apo madje edhe tregon se prindërit e tyre i duan ata. Dhe sigurisht që duhet të dëgjojmë atë që thonë të rinjtë. Por të rriturit kanë përgjegjësi jo vetëm për të dëgjuar, por për të kuptuar se çfarë na thonë fëmijët. Ne tashmë kemi tërhequr vëmendjen për mënyrën se si fëmijët po fillojnë të na tregojnë për lëndimin trupor dhe emocional të shkaktuar nga ndëshkimi trupor (shihni 'A dhemb ndëshkimi trupor', faqe 8). Kur disa fëmijë thonë se kjo është disi e domosdoshme dhe e mirë, ata tregojnë se si janë rritur, të rrethuar nga besimi se dënimi trupor është normal dhe i drejtë, dhe e kanë ngulitur këtë besim, duke marrë qëndrimet dhe sjelljet e prindërve të tyre dhe duke racionalizuar ose duke u përpjekur që t'i japin kuptim lëndimit që ata kanë përjetuar.

Fëmijët kanë të drejtën e patjetërsueshme për të respektuar dinjitetin e tyre njerëzor dhe integritetin e tyre trupor si dhe për mbrojtje të barabartë nga sulmet. Është përgjegjësi e qeverive që të sigurojnë që këto të drejta t'i mbrojnë ligji. Është përgjegjësi e prindërve dhe e të rriturve të tjerë që t'i rrisin fëmijët duke i njohur të drejtat e tyre, dhe t'i respektojnë ato në lidhje me veten dhe të tjerët.

Të qenurit i goditur si fëmijë nuk më ka shkaktuar ndonjë lëndim. A do të isha këtu ku jam sot nëse prindërit e mi nuk do të më kishin disiplinuar fizikisht?

Asnjëri prej nesh nuk e di se si do të ishim në qoftë se prindërit tanë nuk do të na kishin goditur ose poshtëruar. Dhe shumë njerëz, të cilët thonë se kjo nuk u ka bërë ndonjë të keqe, po e mohojnë lëndimin që kanë përjetuar kur të rriturit më të afërt të tyre kanë menduar se mund t'i mësojnë vetëm duke u shkaktuar dhimbje.

Të rriturit që i godasin fëmijët e tyre në emër të disiplinës zakonisht kanë filluar ta bëjnë këtë sepse ata vetë janë goditur si fëmijë. Megjithëse hulumtimet tregojnë se shpeshherë ata ndjehen fajtorë për këtë, ata vazhdojnë t'i godasin fëmijët e tyre, veçanërisht kur janë në fund të durimit të tyre. Është e pakuptimtë të fajësohen brezat e mëparshëm për këtë, sepse ata vepronin në përputhje me kulturën e përhapur të asaj kohe. Por është e gabuar t'i rezistosh ndryshimit, sepse kemi frikë të dukemi se kritikojmë prindërit tanë. Kohët ndryshojnë dhe shoqëritë ecin bashkë me to. Njohja e fëmijëve si zotërues të të drejtave kërkon veprim për t'i dhënë fund ligjshmërisë dhe pranimit social të dhunës ndaj fëmijëve, ashtu siç kanë lëvizur shoqëritë para për t'i dhënë fund pranimit të dhunës ndaj grave.

Disa njerëz thonë: "Unë jam goditur si fëmijë dhe çdo gjë është në rregull." Por ka njerëz që kanë përjetuar të gjitha llojet e përvojave të këqija gjatë rritjes, të cilët "kanë çdo gjë në rregull" si të rritur, megjithatë askush nuk do të thoshte që ajo çka ata kanë përjetuar ka qenë në rregull. Shpesh, mënyra se si ata i kanë përballuar përvojat e tyre i ka ndihmuar që të jenë "në rregull", jo vetë përvojat që kanë pasur.

“Është gabim



t'i rezistosh
ndryshimit,

sepse kemi

frikë të

dukemi se

kritikojmë

prindërit tanë.”



**“Disiplina”
e dhunshme
është forma
më e
zakonshme
e dhunës
ndaj fëmijëve”**

Ka shumë shkelje më të këqija të të drejtave të fëmijëve - pse të fokusohemi në këtë shkelje të vogël?

Siç ka shënuar UNICEF-i, "disiplina" e dhunshme është forma më e zakonshme e dhunës ndaj fëmijëve.⁵ Ndëshkimi trupor vret çdo vit mijëra fëmijë - kryesisht shumë të vegjël - anembanë botës dhe lëndon miliona të tjerë. Nuk është një çështje e parëndësishme ose e vogël.

Por, kjo nuk është thjeshtë një çështje e mbrojtjes së fëmijëve. Ligjshmëria e ndëshkimit trupor në shumë shtete është pasqyrimi më simbolik i statusit të ulët të fëmijëve, ku shikohen si të poseduar dhe si "më pak se njerëz", në vend se të shikoheshin si zotërues të të drejtave të plota. Ndëshkimi trupor pasqyron përvojën e përditshme të shumicës së fëmijëve të botës dhe në çdo rast dënohet dinjiteti dhe integriteti trupor i fëmijës. Ashtu siç ka qenë ndalimi dhe sfidimi i dhunës ndaj grave në familje thelbësor për fuqizimin e grave, dhe pranimin e të drejtave të tyre, e njëjta është me fëmijët. Ndalimi i ndëshkimit trupor përmirëson statusin e fëmijëve dhe kontribuon pozitivisht në atë se si shikohen dhe se si trajtohen ata në shoqëri. Asnjë shtet nuk mund të pretendojë se i respekton fëmijët si zotërues të së drejtës bashkë me të rriturit, dhe as nuk mund të pretendojë se ka një sistem të efektshëm dhe të sigurt për mbrojtjen e fëmijëve, derisa ligji i atij vendi e toleron dhunën ndaj tyre.

5. UNICEF (2014), Hidden in Plain Sight: A statistical analysis of violence against children, NY: UNICEF

Prindërit kanë të drejtë të edukojnë fëmijët e tyre ashtu siç u duket më së miri. A nuk duhet të sfidohen ata vetëm në raste ekstreme të abuzimit të fëmijës?

Shoqëritë po ecin nga ajo që i shihnin fëmijët si pronë e prindërve të tyre në atë si njerëz me të drejtën e tyre. Si qenie njerëzore, fëmijët gëzojnë të drejtat e njeriut - dhe këto nuk përfundojnë tek hyrja e shtëpisë së tyre. Fëmijët kanë të njëjtën të drejtë si të gjithë anëtarët e tjerë të familjes për t'u mbrojtur nga goditja. Këmbëngulja që ligji t'i mbrojë fëmijët nga sulmi në shtëpi nuk është prekje e jetës private dhe familjare më shumë se sa insistimi që të mbrohen të rriturit nga dhuna intime e partnerit.

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës mbështet rëndësinë e familjes dhe promovon konceptin e përgjegjësisë prindërore, me interesat më të mira të fëmijëve si shqetësim themelor i prindërve (neni 18). Disa njerëz argumentojnë çuditshëm, se goditja e një fëmije në emër të disiplinës është, në fakt, në interesin më të mirë të fëmijës në afat më të gjatë kohor. Por, siç ka deklaruar Komisioni për të Drejtat e Fëmijës:⁶

“... Interpretimi i interesave më të mira të fëmijës duhet të jetë në përputhje me të gjithë Konventën, përfshirë obligimin për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës dhe kërkesën për t'i dhënë peshën e duhur pikëpamjeve të fëmijës; Nuk mund të përdoret për të justifikuar praktikën, duke përfshirë ndëshkimin trupor dhe format e tjera të dënimit mizor ose degradues, të cilat bien ndesh me dinjitetin njerëzor dhe të drejtën për integritet trupor të fëmijës.”

Në fund, prindërit gjithashtu kanë të drejtë të përfitojnë nga një mesazh i qartë se dënimi i dhunshëm është i lidhur me marrëdhëniet familjare të keqësuar, dhe një listë të gjatë të rezultateve negative për fëmijët e tyre, pa kurrfarë lidhjeje me ndonjë rezultat pozitiv.

6. Komenti i përgjithshëm Nr. 8 (2006) për “Të drejtën e fëmijës për mbrojtje nga ndëshkimi trupor dhe format e tjera mizore dhe degraduese të dënimit (nenet 19; 28, para. 2; de 37, midis tjerash)”, para. 26, në dispozicion në www.endcorporalpunishment.org/assets/pdfs/reference-documents/CRC-general-comment-8.pdf

Ekziston një dallim i madh në mes të rrahjes së një fëmije dhe një "goditjeje të lehtë dashamirëse." A nuk është ndalimi i ndëshkimit trupor i tepërt?


Rrahja e një fëmije mund të lëndojë fizikisht më shumë se një "goditje e lehtë dashamirëse" (por shihni 'A dhemb ndëshkimi trupor', faqe 8), por të dyja janë një vazhdimësi e dhunës dhe të dyja shkelin të drejtën e fëmijës për respektim të dinjitetit njerëzor dhe integritetit trupor. Shoqëritë nuk caktojnë kufinj dhe nuk përpiqen të justifikojnë asnjë nivel të dhunës kur sfidojnë dhunën ndaj njerëzve të moshuar. Pra, pse ata duhet ta bëjnë këtë kur është fjala për fëmijët? Dhe rreziqet e të bërit ndonjë lidhje në mes të dashurisë ndaj njerëzve dhe lëndimit të tyre duhet të jenë të qarta. Një "goditje dashamirëse" është një kontradiktë e llojit më të keq. Ky term, në dukje i padëmshëm, është një perde pas së cilës mund të fshihen shkeljet e të drejtave të fëmijëve.

Disa njerëz argumentojnë se "ekziston një dallim i madh në mes të abuzimit të fëmijëve dhe një goditjeje të lehtë", duke u fokusuar më pak në qëllimin "dashamirës" të dhunës dhe më shumë në shkallën e dhunës së përdorur. Megjithatë, është e pasaktë të sugjerohet që të rriturit kanë kontroll të saktë mbi shkallën e dhunës që përdorin. Hulumtimet tregojnë se shpesh përdoret më shumë forcë sesa që synohet⁷, dhe se shkalla e forcës përshkallëzohet.⁸ Përsëri, pavarësisht nga ashpërsia e goditjes, ajo shkelë të drejtën e fëmijës për të respektuar integritetin e tij trupor.

7. Kirwaun, S. & Bassett, C. (2008). "Presentation to NSPCC: Physical punishment". Byroja britaneze për hulumtim të tregut/Shoqëria kombëtare për parandalimin e mizorisë tek fëmijë

8. Shergill, S. S. et al (2003), "Two eyes for an eye: The neuroscience of force escalation", Science, vëllimi 301, 11 korrik 2003, p. 187

Ligjberësit dhe qeveritë, tradicionalisht e kanë ndarë "abuzimin e fëmijëve" dhe "ndëshkimin trupor", por pjesa më e madhe e abuzimit është ndëshkim trupor - të rriturit që i sulmojnë fëmijët për t'i dënuar ata dhe për të fituar kontroll. Nuk propozohet asnjë prag i tillë në rastin e dhunës ndaj të moshuarve, ku toleranca zero përcjellë qartë mesazhin se e gjithë dhuna është e papranueshme. Por për fëmijët, të rriturit kanë shpikur një dallim arbitrar midis dhunës ndëshkuese që konsiderohet si e pranueshme dhe "abuzimit", që nuk konsiderohet si i tillë. Në të vërtetë, nuk është e mundur të bëhet dallimi në mes të abuzimit të fëmijëve dhe ndëshkimit trupor.



**“Nuk
ekziston
një gjë si
goditja**

“e sigurtë”.”



Pse të mos definohet goditja e lehtë në vend se të ndalohet plotësisht ajo?

Nuk ekziston një gjë si goditja "e sigurtë". Të gjitha goditjet çenojnë integritetin trupor të fëmijës dhe tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e tyre njerëzor. Shumë hulumtime kanë treguar se format më të buta të ndëshkimit trupor nga prindërit janë një faktor rreziku për dhunën e rëndë që karakterizohet si abuzim, dhe tashmë është diskutuar tendenca drejt përshkallëzimit dhe pasaktësisë personale në gjykimin e madhësisë së forcës së përdorur (shihni "Ekziston një dallim i madh në mes të rrahjes së një fëmije dhe një goditjeje të lehtë dashamirëse. A nuk është ndalimi i ndëshkimit trupor i tepërt?" faqe 20).

Disa vende kanë tentuar të përcaktojnë mënyra të pranueshme të goditjes së fëmijëve - në çfarë moshe, në cilat pjesë të trupit, me çfarë zbatohet e kështu me radhë. Poashtu, dërgimi i një mesazhi të tillë, të paqartë për qëndrimin e shoqërisë për dhunën e fëmijëve, është një praktikë shumë e keqe. Ne nuk do të përpiqeshim të përcaktonim mënyra të pranueshme për sulme ndaj grave, ose të të moshuarve, apo ndonjë grupi tjetër të popullsisë. Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga sulmet. Nëse asgjë tjetër, fëmijët - përgjithësisht më të vegjël dhe më të brishtë se pjesa tjetër e jona - kanë të drejtën për më shumë mbrojtje.

Feja ime kërkon që të përdor ndëshkimin trupor. A nuk do t'ishte diskriminim të më ndalohet përdorimi i saj?

Goditja e fëmijëve nuk është në përputhje me idealet, vlerat dhe besimet e feve të mëdha botërore, të cilat tregojnë dhembshuri, barazi, drejtësi dhe jo-dhunë. Pasuesit e feve botërore e modelojnë jetën e tyre mbi shembullin dhe mësimet e themeluesve të tyre. Studiuesit dhe teologët theksojnë se nuk ka prova të regjistruara që ndonjë nga themeluesit e feve kryesore të kenë goditur një fëmijë.

Pikëpamja fetare që e arsyeton ndëshkimin trupor të fëmijëve shpesh rrjedh nga një kulturë e autoritarizmit, fuqisë dhe kontrollit mbi fëmijët. Ajo e konsideron bindjen e verbër si virtut, dhe ndëshkimin trupor si një përgjigje të pranueshme për fëmijët që konsiderohen "mosbindës".

Udhëheqësit fetarë janë pjesë e lëvizjes globale për të eliminuar ndëshkimin trupor të fëmijëve. Më shumë se 800 liderë fetarë në Asamblenë Botërore të Feve për Paqe në Kioto, Japoni (2006) miratuan një deklaratë – *Një Angazhim Shumë-Fetar për Luftimin e Dhunës ndaj Fëmijëve (Deklarata e Kiotos)*⁹ – e cila kërkon nga qeveritë që të miratojnë ligje që ndalojnë gjithë dhunën ndaj fëmijëve, përfshirë edhe ndëshkimin trupor.

9. Teksti i plotë i kësaj deklarate është në dispozicion në <http://churchesfornon-violence.org/wp/wp-content/uploads/2012/02/Violence-Against-Children-3.pdf>

Komisioni për të Drejtat e Fëmijës, në Komentin e Përgjithshëm nr. 8, pohon se liria fetare "mund të kufizohet ligjërisht në mënyrë që të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve".¹⁰ Ky komision deklaron:¹¹

"Disa justifikime të bazuara në besim për ndëshkimin trupor, duke sugjeruar që interpretime të caktuara të teksteve fetare jo vetëm që e justifikojnë përdorimin e saj, por paraqesin një detyrë për ta përdorur atë. Liria e besimit fetar mbrohet për të gjithë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 18), por praktika e një feje apo besimi duhet të jetë në përputhje me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe integritetit trupor të të tjerëve...."



10. Komenti i përgjithshëm Nr. 8, para. 29

11. Komenti i përgjithshëm Nr. 8, para. 29

Pse ta përdorim ligjin lidhur me këtë? Pse nuk i edukojmë prindërit që të mos përdorin ndëshkimin trupor?

Eliminimi i ndëshkimit trupor dhe dënimeve të tjera mizore ose degraduese kërkon si edukim, ashtu edhe ndalim. Nuk është çështje e zgjedhjes. Të drejtat e njeriut kërkojnë që fëmijët të kenë të paktën të njëjtën mbrojtje ligjore si të rriturit - në familje dhe kudo tjetër - tani. Ligji në vetvete është një mjet i fuqishëm edukativ, dhe sigurisht, reforma ligjore që ndalon ndëshkimin trupor duhet të lidhet me edukimin publik dhe prindëror. Një ndalim do t'i motivojë prindërit që të kërkojnë mënyra pozitive për të rritur/ edukuar fëmijët e tyre dhe për të motivuar profesionistët, politikanët dhe mediat që ta sigurojnë dhe ta ofrojnë këtë edukim.

Është gjithashtu shumë e vështirë dhe e paqartë për t'i edukuar prindërit për diçka që ende mbështetet në ligj. Supozimi është se "nëse ligji e lejon atë atëherë duhet të jetë në rregull". Edukimi është shumë më efektiv atëherë kur ligji jep të njëjtin mesazh.

Pjesa më e madhe e ndëshkimit trupor ndodh në familje mbrapa dyerve të mbyllura; do të jetë e pamundur të zbatohet një ndalim, prandaj ç'është ideja e ndalimit?

Në ditët e sotme askush nuk do të sugjeronte që ne nuk duhet të ndalnim dhunën ndaj të rriturve në familje sepse është e vështirë për policinë: pse fëmijët duhet të kenë më pak mbrojtje ligjore? Qëllimi i parë i reformës ligjore për të ndaluar ndëshkimin trupor është parandalimi - për të parandaluar sulmet e dëmshme ndaj fëmijëve para se të ndodhin. Ky është sigurisht qëllimi i parë i një ligji të mirë: të vendoset një standard i qartë dhe të dërgohet një mesazh i qartë, duke përfshirë edhe "privatësinë" e shtëpisë familjare. Por ndalimi në familje duhet të zbatohet në mënyrë të ndjeshme, në interesin më të mirë të fëmijës – (shih 'A nuk nënkupton kriminalizimi i ndëshkimit trupor që mijëra prindër do të përndiqen dhe që më shumë fëmijë do të dërgohen në përkujdesje?') faqe 40.

Futja e ndalimit të ndëshkimit trupor në ligj duhet të shoqërohet gjithmonë me një fushatë substanciale që ofron informata dhe mbështetje për prindërit për t'i ndihmuar ata që t'ia dalin të bëhen prindër jo të dhunshëm.

Shumë prindër i edukojnë/ rrisin fëmijët e tyre në kushte të vështira dhe mësimdhënësit dhe të tjerët janë në stres për shkak të mbingarkesës dhe mungesës së burimeve. A nuk duhet të presim derisa të përmirësohen kushtet para se të ndalojmë ndëshkimin trupor, në mënyrë që të mos jetë vetëm një stres i shtuar?

Ky argument është një pranim i heshtur i një të vërtete të dukshme: ndëshkimi trupor është shpesh një mënyrë e shfryrjes për ndjenjat e ndrydhura të të rriturve dhe jo një përpjekje për të edukuar fëmijët. Në shumë shtëpi dhe institucione të rriturit kanë nevojë urgjente për më shumë burime dhe mbështetje, por sado reale që të jenë problemet e të rriturve, shfryerja e tyre mbi fëmijët nuk mund të justifikohet. Mbrojtja e fëmijëve nuk duhet të presë për përmirësime në botën e të rriturve, për aq sa edhe mbrojtja e grave nga dhuna që nuk duhet të presë për përmirësimin e kushteve të burrave.

Në çdo rast, goditja e fëmijëve është e paefektshme në lehtësimin e stresit. Të rriturit që godasin nga mosdurimi shpesh ndihen fajtorë. Ata që godasin në mënyrë të qetë thonë se kanë fëmijë të zemëruar dhe të mërziur për t'u përballuar me ta. Jeta në shtëpi dhe institucione ku ndëshkimi trupor është braktisur në favor të disiplinës pozitive është shumë më pak stresues për të gjithë.

Në vendet ku ka konflikte, të rriturit që punojnë me fëmijët, duke përfshirë prindërit dhe mësuesit, janë vetë viktimat e dhunës dhe poshtërimit. Ata bien dakord për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por pyesin se kush po lufton për të drejtat e tyre. Është e qartë se këto shkelje të të drejtave duhet të adresohen, por fëmijët nuk duhet të presin derisa të rriturit të jenë në gjendje t'i gëzojnë të drejtat e tyre. Të gjithë njerëzit sipas ligjit kanë të drejtë për të ju respektuar dinjitetin dhe integritetin trupor, dhe për mbrojtje të barabartë sipas ligjit - edhe fëmijët janë njerëz po ashtu.



**“Fëmijët në
mbarë botën
kanë të drejtë
të jetojnë
jetën pa
asnjë formë
dhune.”**

Kjo është një çështje që ka të bëjë me Evropën dhe të bardhët? Ndëshkimi trupor është pjesë e kulturës sime dhe traditës së rritjes së fëmijës. A nuk është diskriminuese ndalimi i saj me ligj?

Ideja që goditja e fëmijëve mund të jetë çështje krenarie kulturore është e papranueshme. Sidoqoftë, goditja e fëmijëve duket të jetë një traditë e të bardhëve, e eksportuar në shumë pjesë të botës nëpërmjet skllavërisë, kolonializmit dhe disa mësimëve misionare. Për shembull, mbrojtja angleze e "ndëshkimit të arsyeshëm" është pasqyruar në ligje në mbarë botën. Duket se kulturat e vetme ku fëmijët kurrë apo rrallë dënohen fizikisht janë shoqëri të vogla, gjahtar-kërkuese, ndoshta në mesin e më "natyralëve" prej të gjitha kulturave njerëzore, megjithëse tani po zhduket shpejt nën ndikimin e urbanizimit dhe globalizimit.

Por të drejtat e njeriut janë universale, dhe fëmijët në mbarë botën kanë të drejtë të jetojnë jetën pa asnjë formë dhune. Të gjitha kulturat kanë përgjegjësi për të mohuar ndëshkimin trupor, ashtu siç kanë mohuar shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut të cilat formojnë një pjesë të traditave të tyre. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës mbështet të gjitha të drejtat e fëmijëve për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës trupore ose mendore, pa diskriminim në bazë të racës, kulturës, traditës apo fesë. Ka lëvizje për t'i dhënë fund ndëshkimit trupor të fëmijëve në shumë shtete të botës, në të gjitha kontinentet. Rrahjet në shkollë janë të jashtëligjshme në shumë shtete në të gjitha rajonet e botës.

Pse është aq e vështirë që të hiqet dorë nga goditja e fëmijëve?

Nëse të rriturit, përfshirë edhe politikanët, e konsiderojnë këtë çështje të lehtë, do të kishim pranuar kohë më parë që fëmijët të kenë të njëjtat të drejta si të tjerët për të respektuar dinjitetin e tyre njerëzor, integritetin trupor, dhe mbrojtjen e barabartë sipas ligjit. Në të vërtetë, ne me gjasë do të pranonim se fëmijët, të cilët janë shumë të vegjël dhe shumë të brishtë, kanë të drejtë për më shumë mbrojtje sesa të rriturit.

Duket se ekzistojnë një numër arsyesh që të rriturit e kanë të vështirë të heqin dorë nga ato që ende perceptohen si një "e drejtë" për të goditur dhe për të lënduar fëmijët në emër të "disiplinës" ose kontrollit:

(i) Përvoja personale. Shumica e njerëzve, kudo, janë goditur si fëmijë nga prindërit e tyre. Shumica e prindërve kanë goditur fëmijët e tyre. Asnjëri prej nesh nuk dëshiron të mendojë keq për prindërit tanë, ose për mënyrën tonë të të qenurit prind, dhe kjo e bën atë sfiduese për shumë njerëz, duke përfshirë politikanët dhe udhëheqësit e mendimeve, madje edhe ata që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve, të perceptojnë ndëshkimin trupor si çështje themelore të barazisë dhe të të drejtave të njeriut, ashtu siç është. Kjo nuk është çështje e fajit - prindërit kanë vepruar në përputhje me pritjet sociale - por ka ardhur koha për të kaluar në marrëdhënie pozitive dhe jo të dhunshme me fëmijët.



(ii) Të rriturit shpesh i godasin fëmijët sepse janë të zemëruar ose të stresuar, ose në fund të durimit të tyre. Shumë të rritur e dinë, thellë në zemrat e tyre, se goditja është një reagim emocional për atë që po ndodh dhe jo një vendim racional për "disiplinimin" e fëmijës. Sa më shpesh që të ndodhë kjo, aq më shumë goditja e një fëmije bëhet një mënyrë automatike për t'u ballafaquar me sjellje çapkëne. Nuk është e lehtë të ndryshosh sjelljet automatike por mund të ndryshohen. Ndërsa qeveritë investojnë në edukim dhe vetëdijesim publik lidhur me mënyrat pozitive, jo të dhunshme të rritjes së fëmijëve dhe të drejtën e fëmijëve për respektimin e dinjitetit dhe integritetit të tyre trupor, prindërit do të zhvillojnë një sërë mënyrash për t'u ballafaquar me sjelljen që nuk u pëlqen, pa e ndjerë nevojën për të sulmuar fëmijët e tyre.

(iii) Mungesa e njohurive rreth alternativave. Reforma ligjore duhet të shoqërohet me edukimin e prindërve, fëmijëve dhe shoqërisë në përgjithësi për një numër të madh mënyrash pozitive dhe jo të dhunshme që të rriturit mund të merren me fëmijët.



**Pjesa 2:
Pyetjet për
ndikimin e
ndalimit të të
gjitha formave
të ndëshkimit
trupor**



Nëse prindërit detyrohen të heqin dorë nga ndëshkimi trupor, a do të përfundojnë fëmijët të lazdruar, duke mos respektuar askënd dhe asgjë?

Jo! Disiplina nuk është e njëjtë sikurse dënimi. Disiplina e vërtetë nuk bazohet në forcë. Ajo kultivohet nga mirëkuptimi, respekti i ndërsjellë, toleranca dhe komunikimi i dyanshëm. Bebet lindin plotësisht të varur dhe, ndërsa rriten, mbështeten tek të rriturit - veçanërisht prindërit e tyre - për t'i udhëhequr dhe mbështetur ata drejt pjekurisë së vetë-disiplinës. Ndëshkimi trupor nuk u tregon fëmijëve asgjë se si duhet të sillen. Përkundrazi, goditja e fëmijëve është një mësim i sjelljes së keqe. Ajo i mëson fëmijët se si prindërit e tyre e konsiderojnë të pranueshme përdorimin e dhunës për të zgjidhur problemet ose konfliktet.

Goditja e fëmijëve gjithashtu dërgon mesazh të paqartë tek fëmijët, të cilët megjithëse nuk duhet të godasin fëmijët e tjerë ose të rriturit dhe të rriturit nuk duhet të godasin të rriturit e tjerë, kjo është në rregull për të rriturit, të cilët janë më të mëdhenjë dhe më të fortë, që të godasin fëmijët, të cilët janë më të pambrojtur. Fëmijët mësojnë nga ajo që bëjnë prindërit e tyre, jo vetëm nga ajo që ata thonë.

Respekti nuk duhet të ngatërrohet me frikë. Sjellja "e mirë" për shkak të frikës nga ndëshkimi do të thotë që një fëmijë shmang dënimin dhe jo që tregon respekt. Fëmijët

mësojnë të respektojnë me të vërtetë njerëzit dhe gjërat atëherë kur e vlerësojnë vlerën e tyre të brendshme. Kur prindërit i godasin fëmijët në emër të disiplinës, fëmijët mësojnë të "sillen" vetëm për të shmangur dënimin dhe e mësojnë se dhuna është një mënyrë e pranueshme për trajtimin e mosmarrëveshjeve. Por, kur prindërit tregojnë respekt për dinjitetin dhe integritetin e fëmijëve të tyre dhe të të tjerëve, fëmijët e mësojnë respektin. Kur prindërit i dispiplinojnë fëmijët e tyre në mënyra pozitive dhe jo të dhunshme, fëmijët mësojnë se konflikti mund të zgjidhet pa e dëmtuar këtë respekt.

Ndëshkimi trupor dhe format e tjera mizore dhe degraduese të dënimit nuk janë zëvendësim i formave pozitive të disiplinës. Disiplina pozitive është projektuar për të siguruar që ata të mësojnë të mendojnë për të tjerët dhe për pasojat e veprimeve të tyre dhe në asnjë mënyrë për të llastuar fëmijët. Shtetet kanë obligim që të mbështesin kujdesin prindëror pozitiv. Ka shumë materiale në dispozicion për promovimin e kujdesit prindëror pozitiv dhe edukimit pa dhunë, të cilat mund të përshtaten dhe të përkthehen për përdorim në çdo vend.



Nëse ndëshkimi trupor ndalohet, a nuk do të shpije kjo në trajtim më të tmerrshëm të fëmijëve - abuzim emocional, poshtërim ose mbyllje ?

Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes jo vetëm nga ndëshkimi trupor, por edhe nga të gjitha format e tjera të ndëshkimit ose trajtimit mizor ose degradues. Reforma ligjore duhet të lidhet me rritjen e vetëdijesimit dhe promovimin e marrëdhënieve pozitive dhe jo të dhunshme me fëmijët.

Prindërit duan që fëmijët e tyre të kenë fillimin më të mirë të mundshëm në jetë. Prindërit që godasin fëmijët e tyre ose i keqtrajtojnë ata në mënyra të tjera nuk ndjehen mirë për këtë - ata përgjithësisht ndjehen të mërzitur dhe fajtorë. Shumica e prindërve do të mirëprisnin këshillat dhe mbështetjen për atë se si të parandalonin dhe zgjidhnin konfliktet me fëmijët e tyre pa përdorur asnjë lloj forme të dhunës, qoftë trupore apo emocionale. Kalimi nga goditja dhe poshtërimi i fëmijëve në trajtimin e tyre si njerëz dhe zotërues të të drejtave përkrah të gjithë të tjerëve, përmirëson jetën familjare për të gjithë.

A nuk nënkupton kriminalizimi i ndëshkimit trupor, që mijëra prindër do të përndiqen, dhe që më shumë fëmijë do të dërgohen në përkujdesje?

Qëllimi i një ligji që ndalon ndëshkin trupor nuk është që të dërgojë më shumë prindër në burg. E gjithë kjo është për të përmbushur të drejtat e fëmijëve dhe për të lëvizur shoqëritë drejt marrëdhënieve pozitive, jo të dhunshme me fëmijët. Nuk ka dëshmi për rritjen e ndjekjes penale të prindërve nga rritja e numrit të shteteve ku ndëshkimi trupor është bërë vepër penale.

Ndalimi i ndëshkimit trupor përmbushë obligimet e shteteve për të drejtat e njeriut ndaj fëmijëve. Qëllimi i tij i parë është edukimi – dërgimi i një mesazhi të qartë në privatësinë e shtëpisë që goditja e fëmijëve nuk është më e pranueshme apo e ligjshme - aq sa nuk është as goditja e kujt do tjetër. Udhëzimi për të gjithë ata që janë të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë këtu edhe autoritetet e policisë dhe prokurorisë, duhet të sigurojë që zbatimi i ligjit është i fokusuar në interesin më të mirë të fëmijës. Prokuroria dhe ndërhyrjet e tjera formale nuk kanë gjasa të jenë në përfitim të fëmijëve, përveç nëse ato janë mënyra e vetme për të arritur tek mbrojtja e nevojshme nga dëmtimet e mëdha.



Në komentin e tij të përgjithshëm nr. 8, Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve shpjegoi dy parimet që duhet të sigurojnë që ndalimi nuk rezulton në një numër të madh ndjekjesh penale të prindërve:

1. Parimi "*de minimis*" – nënkupton që ligji nuk duhet të merret me çështje të parëndësishme dhe ai është arsyeja pse sulmet e vogla në mes të të rriturve vijnë shumë rrallë në gjykatë. I njëjti parim do të zbatohet për sulmet "e vogla" të fëmijëve nga ana e të rriturve.
2. Për shkak të varësisë së fëmijëve dhe intimitetit unik të marrëdhënieve familjare, vendimi për të ndjekur penalisht prindërit ose për të ndërhyrë në jetën familjare duhet të merret me kujdes të madh dhe duhet të bëhet vetëm kur është e nevojshme për t'i mbrojtur ata nga dëmtimet e mëdha dhe në interesin më të mirë të fëmijës.

A nuk është në rregull që prindërit t'i qëllojnë lehtë fëmijët e tyre për t'i ndaluar që të vetë-lëndohen?

Goditja e lehtë e fëmijëve për t'i ndaluar që të vetë-lëndohen nuk ka kuptim! A mund ta paramendoni këshillimin e prindërve se kur fëmijët e tyre janë në rrezik, ata duhet t'i godasin ata? Natyrisht që jo.

Prindërit duhet të përdorin veprime trupore për mbrojtjen e fëmijëve - sidomos për foshnjat dhe fëmijët e vegjël - gjatë gjithë kohës. Kjo është një pjesë e natyrshme e kujdesit prindëror. Nëse një fëmijë zvarritet drejt zjarrit, ose vrapon në një rrugë të rrezikshme, prindërit natyrshëm përdorin mjete trupore për t'i ndaluar ata - duke i kapur, duke i mbajtur, duke u treguar për rrezikun. Por, t'u shkaktohet atyre dhimbje duke i goditur, e dobëson mesazhin që ata duhet ta mësojnë, për ta mbajtur veten të sigurtë dhe, derisa të jenë në gjendje ta bëjnë këtë, prindërit e tyre duhet t'i mbajnë ata të sigurtë. Ndërsa Komisioni për të Drejtat e Fëmijës shpjegon:¹²

"... kujdesi prindëror për fëmijët, sidomos për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, kërkon veprime dhe ndërhyrje të shpeshta trupore për t'i mbrojtur ata. Kjo dallon shumë nga përdorimi i qëllimshëm dhe ndëshkues i forcës për t'u shkakuar atyre dhimbje, shqetësim ose poshtërim. Si të rritur, ne e dimë për vete dallimin midis një veprimi trupor mbrojtës dhe një sulmi ndëshkues; Nuk është më e vështirë të bëhet një dallim në lidhje me veprimet që përfshijnë fëmijët."

12. Komenti i përgjithshëm nr.. 8, para.

Ekziston një dallim shumë i qartë midis përdorimit të forcës për mbrojtjen e fëmijëve dhe përdorimit të saj për të ndëshkuar dhe për t'i lënduar qëllimisht. Ligji në të gjitha shtetet, në mënyrë eksplicite apo implicite, lejon përdorimin e forcës jo ndëshkuese dhe të nevojshme për mbrojtjen e njerëzve. Largimi i të drejtës për përdorimin e forcës për ndëshkim nuk ndërhyt aspak në këtë të mëparshmen.



Uebfaqja e Nismës Globale:

www.endcorporalpunishment.org

Informata të detajuara për të gjitha aspektet e ndalimit të ndëshkimit trupor janë në dispozicion në uebfaqen e Nismës Globale, përfshirë këtu:

- Raportet e detajuara individuale për secilin shtet dhe territor në mbarë botën
- Tabelat globale dhe rajonale që paraqesin ligjshmërinë e ndëshkimit trupor dhe mundësitë e menjëhershme për arritjen e reformës ligjore
- Mënyrat se si sistemet e OKB-së dhe ato rajonale për të drejtat e njeriut adresojnë ndëshkimin trupor dhe udhëzime për mënyrën se si të përdoren këto mekanizma në promovimin e reformës ligjore
- Përmbledhje të hulumtimit në popullaritetin e ndëshkimit trupor dhe qëndrimet për të, si dhe ndikimi i ndëshkimit trupor tek fëmijët, të rriturit dhe shoqëritë
- Informata për mbështetjen e implementimit të ndalimit
- Një numër burimesh globale dhe rajonale për avokim, përfshirë burimet në dispozicion në një numër gjuhësh



Ka ardhur koha për t'i dhënë fund të gjitha formave të ndëshkimit trupor të fëmijëve. Fëmijët kanë të drejtë për t'u respektuar dhe për të pasur mbrojtje të barabartë nga të gjitha format e dhunës tani!

Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve

Nisma globale për t'i dhënë fund ndëshkimit trupor të fëmijëve promovon ndalimin e përgjithshëm dhe eliminimin e ndëshkimit trupor dhe ofron mbështetje teknike dhe këshilla për të gjitha aspektet e reformës ligjore.

www.endcorporalpunishment.org

info@endcorporalpunishment.org

www.twitter.com/Glencorpun

www.facebook.com/Glencorporalpunishment

Save the Children Suedi

Save the Children Suedi avokon për ndalimin e ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset. Në vitin 1979, Save the Children Suedi ka kontribuar që Suedia të bëhet vendi i parë në botë që të ndalojë shprehimisht ndëshkimin trupor. Kjo organizatë po punon në theksimin e kësaj çështjeje për arritjen e një ndalimi ligjor dhe eliminimin e ndëshkimit trupor dhe për ta vënë këtë çështje në agjendën politike në mbarë botën.

info@rb.se

www.raddabarnen.se

resourcecentre.savethechildren.net





Global Initiative to
End All Corporal Punishment
of Children



Save the Children



SWEDEN
